



## Departamenti i Prokurimit

Prishtine: datë, **02.03.2022**

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 25.02.2022 të parashtruar nga OE **“EL-BAU SH.P.K., LIMON STANECI P.N., - , GJILAN, Kosovë**; lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Intervenime emergjente – pastrimi i shtratit të lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik”**, me Nr. të Prok: **616-21-8437-5-2-1** dhe numër të brendshëm 616 21 005 511 nxjerr:

### V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa për ri-shqyrtim e OE **“EL-BAU SH.P.K., LIMON STANECI P.N., - , GJILAN, Kosovë**; të dt. 28.02.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Intervenime emergjente – pastrimi i shtratit të lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik”** me **616-21-8437-5-2-1** dhe Nr. Brendshëm 616 21 005 521, kundër Vendimit të *Njoftimit të AK* së, të datës: 21/02/2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së
2. AK vendos që ta kthejë në rivlerësim aktivitetin e prokurimit: **“Intervenime emergjente – pastrimi i shtratit të lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik”** me numër të prokurimit: **616-21-8437-5-2-1** dhe Nr. Brendshëm 616 21 005 521, në mënyrë që komisioni për rivlerësim ta riezaminojë edhe njëher ofertën e grupit të OE **“Grup i Operatorëve Ekonomik AGRO INVEST 1 SH.P.K.; DARDANIAA SH.P.K.**, dhe ofertat tjera të dorëzuara për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

OE "EL-BAU SH.P.K., LIMON STANECI P.N., -, GJILAN, Kosovë" me datë 28.02.2022, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Intervenime emergjente – patrimi I shtratit te lumenjeve dhe kanalizimit atmosferik", me Nr. të Prok: 616-21-8437-5-2-1 dhe numër te brendshëm 616 21 005 521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 02.03.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

AK do ta beje rivleresimin e ofertave, dhe po ashtu duke u bazuar ne nenin 72 te LPP (Dokumentacioni dhe informacioni shtese), do te kerkoj nga Grupi i OE "Grup i Operatorëve Ekonomik AGRO INVEST 1 SH.P.K.;DARDANIAA SH.P.K. sqarime lidhur me pretendimet e cekura nga OE ankues.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më larte ka vendosur si ne dispozitiv.  
Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.  
Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij Vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit